

Datë \_\_.08.2023

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim i Monitorimit dhe Menaxhimi i Poliemergjencave”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
71700000-5 – Shërbime Kontrolli dhe monitorimi**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 10 020 834** (dhjetë milion e njëzetë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) **Lekë pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në vlerën \_\_\_\_\_ Lekë ( ).*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar)

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Kopje të çertifikuara të bilanceve të vitit 2020, 2021 dhe 2022 të leshuara nga administrata tatimore., ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, 2020, 2021 dhe 2022

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % vlerësse fondit limit të kontratës objekt prokurimi. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77,pika 1/b dhe pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/c dhe pika 3, neni 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

**2.2.3.** Operatorët ekonomik duhet të paraqesin një vërtetim të lëshuar nga administrata e qeverisjes vendore, që konfirmon shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, përfshirë edhe këstin e maturuar të vitit 2023, për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifat vendore. (kjo pikë plotësohet me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit sipas parashikimeve ligjore.

**Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” indryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” indryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” indryshuar, sidhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që ka realizuar shërbime të ngjashme, me vlerë jo më pak se 20 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të ketë selinë e aktivitetit të tij në Tiranë ose vend të ushtrimit të aktivitetit patjetër në qytetin e Tiranës për arsye të dinamikës së kryerjes së shërbimit dhe përgjigjes 24 orë në rast të problemeve apo kërkesave, kryerjes së shërbimit në orët e vona të natës etj. Për këtë arsye, është e nevojshme që OE të ketë selinë në Tiranë, në mënyrë që t’i përgjigjet kërkesave të AK në mënyrë të menjëhershme e cila vërtetohet me Ekstraktin e QKB-së.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4/ç të VKM nr.285 ,datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që zoteron pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**2.3.3.** Për ofrimin e shërbimit të kërkuar Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 11 (njëmëbëdhjetë) punonjës, të profileve si më poshtë:

- 5 (pesë) punonjës operatore të certifikuar
- 3 (tre) teknik elektronik
- 1 (një) Inxhinier elektronik,
- 1 (një) specialist i teknologjisë së sigurisë dhe informacionit,
- 1 (një) mjek i përgjithshëm.

Për punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **3 muajt e fundit**.

Për plotësimin e këtij kriteri Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- kontratat e punës të vlefshme
- diplomat përkatëse
- listëpagesa e 3 (tre) muajëve të fundit

*Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomik, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. (Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/2. Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme).*

**Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Kriteria të vendosura në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b dhe 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: pika 4/ b një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës dhe/ose pika 4/ c, fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

**2.3.4.**Për ofrimin e shërbimit të kërkuar Operatori ekonomik duhet të disponoj një autoambulancë, me vit prodhimi minimumi 2005.

Për plotësimin e këtij kriteri Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si vijon:

**a.***Aktin e pronësisë së mjetit përkatës*, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, taksa e mjetit dhe siguracioni i mjetit (i vlefshëm) dhe foto të autoambulancës.

**Ose**

**b.***Kontratën e marrjes me qira të mjetit*, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të përkojë me afatin e realizimit të shërbimit të kërkuar. Kontrata e qirasë duhet të shoqërohet me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, taksa e mjetit dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme)dhe foto të autoambulancës

**Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Kriter i vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojnë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

**2.3.5** Autoambulanca duhet të jetë e pajisur me mjete të nevojshme të renditura si më poshtë:

- 1-Monitor/Defibrillator Lifepak 12 (ecg, spo2, aed/manual, peacer)
- 2-Aspirator qendror me vakum
- 3-Aspirator portabël

- 3-Ventilator/Respirator
- 4-Shiringë elektrike
- 5.1- Barrelë konvecionale me rrota
- 5.2- Barrelë lugë
- 5.3- Barrelë carcaf
- 5.4- Barrelë e drejte/ spinale me mobilizuesit e qafes
- 6-KED mobilizues i vertebrave (cerviko, torako, abdomeno lumbare).
- 7- Set mikrokirurgjikal (portage, klem, pincet anatomike, suture)
- 8- Bombula Oksigjeni:
  - a.2x 10L stacionale
  - b.2x 5 L portabël
  - c.1x 2L portabël për Respiratorin/ventilatorin
- 9- Ballon Ambulator

\*Të gjitha mjetet e lartpërmendura duhet të jenë shoqëruar me fotot përkatëse.

**Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Kriter i vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim ku të deklarojë se mjete i paraqitur nuk është i angazhuar në kontrata të tjera. Kjo deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese duhet të përmbajë vendndodhjen e sakte të mjetit në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi.

**Argumentimi:** Kriter i vendosur në reference të specifikimeve teknike me qëllim realizimin sipas afateve të përcaktuara nga AK.

***Shënim:*** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pare duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

***-Në të gjitha rastet kur përdoret emri ose marka, njihet njëvlefshmëria apo barazvlefshmëria, ose ekuivalent***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi Ç) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

*ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.